

FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR SHQIPËRI

Konkluzionet Paraprake të Stafit të Misionit pas Diskutimeve për Artikullin IV 2011

22 Qershor 2011

1. **Ekonomia shqiptare ka treguar një ecuri të admirueshme në të shkuarën e afërt.** Shqipëria e përballoi mirë krizën financiare botërore të vitit 2009 dhe ndryshe nga shumica e ekonomive europiane, shmangu një rënie dhe ka kryesuar përsëri rritjen ekonomike në rajon. Për më tepër, megjithë përkeqësimin thelbësor në cilësisë e aktiveve, sektori financiar e provoi veten të qëndrueshëm dhe nuk pati nevojë për mbështetje nga fondet publike. Gjatë gjithë kësaj kohe, inflacioni ka mbetur i mirëankoruar. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, ribalancimi i nevojshëm i ekonomisë ka filluar, eksportet janë rritur, si dhe defiqiti i lartë i llogarisë korente ka nisur të ngushtohet.
 2. **Megjithatë, si edhe në shumë vende të tjera, rritja është ngadalësuar nga nivelet e larta të para krizës.** Rritja ekonomike për vitin 2010 vlerësohet rreth 3½ për qind dhe ne parashikojmë që të ngadalësohet më tej në 2½ përqind në 2011, për shkak të kërkesës së dobët vendase dhe eksporteve më të moderuara. Duke qenë se potenciali i përafrimit mbetet dhe investimet e kohëve të fundit në infrastrukturë do të bëhen funksionale, në afatin e mesëm, rritja mund të rimëkëmbet në rreth 4 përqind me disa përmirësime në qëndrueshmërinë e sektorit të jashtëm. Këto nivele, megjithëse të respektueshme, janë ndjeshëm nën mesataren prej 6 përqind të dhjetëvjeçarit të shkuar dhe gjithashtu subjekt i rreziqeve, përfshirë dhe ato që rrjedhin nga niveli i lartë i borxhit publik.
 3. **Politikat ekonomike duhet të veprojnë për të rritur qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike dhe për të ngushtuar sa më shpejt hendekun në standardet e jetesës.** Arritja e njëkohshme e një rritje ekonomike më të fortë dhe me bazë të gjerë, rezistence më të lartë ndaj rreziqeve, si dhe qëndrueshmëria e sektorit të jashtëm janë të mundura.
- Konsolidimi fiskal i bazuar në një kuadër politikash të qëndrueshme*
4. **Konsolidimi fiskal është prioriteti afat-shkurtër dhe afat-mesëm për të përmirësuar ecurinë ekonomike dhe për të ulur riskun.** Kjo do të ulte riskun e shoqëruar me nivelin e lartë të borxhit publik dhe do të përshpejtonte qëndrueshmërinë e sektorit të jashtëm duke ndihmuar në ngushtimin e defiqtit të llogarisë korente. Për më tepër, defiqtitet më të ulëta do të nxisnin rritjen ekonomike të udhëhequr nga sektori privat, duke rritur fluksin e kredive për ekonominë dhe siguruar norma më të ulëta interesi.
 5. **Ashtu si në 2010, buxheti është përsëri nën presion.** Me politikat dhe trendin aktual defiqiti parashikohet të rritet në 4½ përqind të PBB-së në 2011 dhe mbi 5 përqind në afatin e mesëm. Kjo do të çonte borxhin publik shumë afër tavanit ligjor. Ashtu siç ndodhi vitin e kaluar, një tjetër rishikim i buxhetit në mes të vitit bëhet i domosdoshëm. Duhet të realizohen shkurtime prej rreth 1½ përqind e PBB-së (20 miliardë lekë). Në vitet e ardhshme do të kërkohej akoma më shumë përpjekje për konsolidim fiskal.

6. **Mosrealizimi i përsëritur i buxhetit nënvizon nevojën për një kuadër makroekonomik më realist.** Aktiviteti më i dobët ekonomik i ka vënë nën presion të ardhurat, por mosrealizimi krahasuar me buxhetin fillestar pasqyron kryesisht parashikimet tepër optimiste. Parashikime më realiste për të ardhurat mund të arrihen nëse ato do t'i ngarkohen një këshilli fiskal të pavarur dhe apolitik apo duke i bazuar ato në parashikimet e pavarura të institucioneve profesionale. Surprizat pozitive në të ardhura, duhet të shkojnë për uljen e borxhit.

7. **Një rregull fiskal i bazuar tek shpenzimet mund të përbëjë fokusin e një politike fiskale të qëndrueshme.** Nevoja e kohëve të fundit për shkurtime të paplanifikuara të shpenzimeve në mes të vitit, rrezikon përfundimin e projekteve të rëndësishme të infrastrukturës, mund të shkaktojë detyrime të pashlyera dhe vonesa në pagesa, si dhe të çojë në rritjen e shpenzimeve të institucioneve buxhetore të linjës në fillim të vitit. Nëse buxheti bazohet në një rritje të kufizuar të shpenzimeve, këto rreziqe shmangen, uljet nxitja për një optimizëm të tepruar në parashikimin e të ardhurave, ndihmon në largimin e dyshimeve të investitorëve lidhur me angazhimin e qeverisë për një qeveri të vogël, si dhe ofrohet një ancorë afat-mesme për uljen e borxhit. Për shembull, objektivi i parakrizës i qeverisë për të ulur borxhin në 50 përqind të PBB-së në afatin e mesëm, mund të arrihet nëse kufizohet rritja reale vjetore e shpenzimeve primare në 1³/₄ përqind.

8. **Konsolidimi i nevojshëm fiskal do të kërkojë masa të besueshme dhe përpjekje të vazhdueshme.** Interesat, pagat dhe transfertat përbëjnë më shumë se dy të tretat e çdo leku që qeveria mbledh në taksa dhe tarifa. Nëse shpenzimet kapitale do të mbahen në nivelin aktual të PBB-së, pagat dhe transfertat do të duhet të indeksohen vetëm me inflacionin.

9. **Nëse shkurtimeve të shpenzimeve shihen si jo realiste, atëherë taksat direkte ose kontributet duhet të rriten.** Një prej masave mund të jetë anulimi i uljes së mëparshme të normës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, sidomos duke qenë se nuk ka rezultuar në rritjen e shpresuar të zbatimit të ligjit. Kjo do të ndihmonte në uljen e deficitit të pensioneve—i cili në 1 përqind të PBB-së është në një nivel të lartë, kur shikohet në kontekstin e një popullsie në moshe të re dhe në rritje në Shqipëri—si dhe do të ndihmonte reformën e vonuar të pensioneve. Përveç kësaj, norma mjaft e ulët e taksës së sheshtë mund të rritet pa rrezikuar pozicionin konkurrues të Shqipërisë. Ka gjithashtu hapësirë për të përmirësuar administrimin e taksave, por kjo nuk është pa kosto. Për shembull, kreditet e akumuluar të TVSH-së dhe aplikimet për rimbursim që nuk janë procesuar kanë arritur një nivel shumë të lartë dhe duhet të shlyhen shpejt si dhe rimbursimet korente të paguhen në kohë. Kjo do të jetë kritike për të rritur mbledhjen e taksave në të ardhmen.

10. **Duhet të vazhdohen përpjekjet për të përmirësuar menaxhimin e borxhit.** Debutimi i suksesshëm i Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit me shitjen e një Eurobondi i ka ulur rreziqet afatshkurtra të rifinancimit. Nevojitet më shumë progres për të zgjatur maturitetin e borxhit të brendshëm dhe për të zhvilluar tregun në lek. Konsolidimi fiskal do të ndihmojë që kjo të arrihet më një kosto të arsyeshme.

Ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar

11. **Kuadri i politikës monetare me një regjim inflacioni të shënjestruar dhe kurs këmbimi fleksibël është një nga pikat e forta kryesore të ekonomisë shqiptare.** Megjithatë çmimet më të larta të importuara dhe rritjen në çmimet e administruara dhe të akcizave, inflacioni parashikohet të kthehet

shpejt brenda intervalit të synuar të Bankës së Shqipërisë falë besueshmërisë së saj dhe një politike të vendosur dhe në kohën e duhur të rregullimeve të kushteve monetare.

12. Një kombinim më i mirë i politikave makroekonomike është megjithatë i domosdoshëm. Përmirësimi i ecurisë fiskale do të jetë kritik për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit të jashtëm si dhe për të arritur objektivin e inflacionit me norma më të ulëta reale të interesit. Kjo do të vlente edhe më shumë nëse flukset e kapitalit do të rriteshin.

13. Mbikqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar duhet të mbeten përpara sfidave të vazhdueshme. Ndikimi i kufizuar nga kriza financiare globale i detyrohet shumë politikave të mëparshme proaktive, rregullimit dhe mbikqyrjes së fortë. Megjithatë, përmirësimi i balanceve ka ende rrugë për të bërë, inovacioni financiar po përparon dhe sfida të reja ndërkombëtare dhe vendase janë në horizont, prandaj vigjilenca e vazhdueshme është kyçe. Fushat prioritare përfshijnë forcimin e pavarësisë së institucioneve mbikqyrëse, përsheptimin e ekzekutimit të kolateralit, ruajtjen e likuiditetit, përmirësimin e kuadrit të stres-testeve dhe përditësimin e planeve të kontigjencës.

Përmirësimi i klimës së biznesit dhe ruajtja e arritjeve të së shkuarës

14. Rritja e produktivitetit nëpërmejt tërheqjes së investimeve të huaja është kyçe për një rritje ekonomike të qëndrueshme më të lartë. Dhjetëvjeçari i fundit ka shënuar ardhjen e investitorëve të mëdhenj ndërkombëtarë në Shqipëri, një faktor kritik për transferimin e teknologjisë dhe inovacionit, që nga ana tjetër janë thelbësore për rritjen e produktivitetit dhe mundësinë e sigurimit të punësimit me paga më të larta në Shqipëri.

15. Një mjedis i favorshëm për investimet është kusht vital për sukses. Prespektiva europiane e Shqipërisë është një element kyç për të tërhequr investitorët. Të tjera kërkesa kryesore përfshijnë rregulla loje të njëjta për të gjithë, adoptimin e rregullimeve të bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe zbatimin e parashikueshëm të tyre nga institucione profesionale. Është gjithashtu e rëndësishme të këmbëngulet në axhendën e reformave ku ka ngadalësim relativ në vitet e fundit; më shumë veprim është sidomos i rëndësishëm në sigurimin e të drejtave të pronësisë, pronësinë e tokës, si edhe në zbatimin e kontratave.

16. Statistikat ekonomike me cilësi të lartë janë thelbësore për përmirësimin e politikë-bërjes dhe klimës së biznesit. Përpjekjet e autoriteteve që synojnë përmirësimin e statistikave ekonomike janë të mirëpritura dhe progresi i mëtejshëm për të përmirësuar bazën statistikore është thelbësor. Fushat prioritare për përmirësim përfshijnë statistikën e sektorit të jashtëm dhe llogaritë kombëtare. Instat-i duhet të pajiset me burimet e përshtatshme për të bërë efektive asistencën teknike thelbësore që ka marrë nga komuniteti ndërkombëtar.

Misioni shfrytëzon rastin për të falenderuar autoritetet për mikpritjen e ngrohtë, bashkëpunimin e shkëlqyer dhe diskutimet e frytshme.